

LANGUAGE STRUCTURING IN THE BILINGUAL SITUATION (THE CASE OF ALBANIAN SPEAKERS)

Rrezarta Draçini

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Albania, rezarta.dracini@unishk.edu.al

Rezearta Murati

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Albania, rezearta.murati@unishk.edu.al

Abstract: The latest movement of people from one place to the other and new opportunities in employment and education have created a new linguistic situation in the last 30 years. The individual, when he is found in between an inter-language conflict, is involved in bilingualism. The speaker in a bilingual situation is found in a situation of conflict and ambiguity, because he feels he cannot converse fluently. A bilingual speaker must ask himself subconsciously at the beginning of every linguistic interaction, if he is in a monolingual or in a bilingual model of language production or decodification.

In this work we aim to observe the situation of second language acquisition and usage according to a new viewpoint, which is supported on contemporary literature with methodologies and analyses which these new theories offer. We will analyze:

- How does the status of the language change through the years?
- How do languages in bilinguals grow or wither and which factors affect that?
- How do bilinguals choose between the different languages?
- How do bilinguals behave themselves in different linguistic situations?
- How do bilinguals deactivate other languages when they find themselves in the monolingual mode by placing themselves in the monolingual part of speech and how do they switch to the bilingual mode?

In this work we will analyze the influence of the Albanian language with its specifics, in the cases in which it is the L1 for the speakers.

We will present the results of research done with individuals which use two or more languages. This research spans through a wide timescale and the individuals have been observed for many years.

Keywords: bilingualism, monolingual, the Albanian language, perception, linguistic structure.

STRUKTURIMI GJUHËSOR NË SITUATËN E BILINGUIZMIT (RASTI I SHQIPFOLËSVE)

Rrezarta Draçini

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shqipëri, rezarta.dracini@unishk.edu.al

Rezearta Murati

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shqipëri, rezearta.murati@unishk.edu.al

Abstrakt: Lëvizjet e shumta të njerëzve nga njëri vend në tjetrin, hapësirat e reja që janë krijuar për punësim dhe studim kanë krijuar një situatë të re gjuhësore 30 vitet e fundit. Individu i gjendur në përballje ndërgjuhësore është përfshirë në bilinguizëm. Individfolësit në situatë të bilinguizimit e gjejnë vetem mes dilemash dhe paqartësisë, pasi e ndiejnë se nuk janë bashkëbisedues me rrjedhshmërinë e dëshiruar.

Një bilingual në mënyrë të pandërgjegjshme duhet t'i bëjë vetes shpesh, në fillim të ndërveprimit apo gjatë tij, pyetjen, kur ata janë në një model monolingual apo model bilingual të prodhimit apo dekodifikimit gjuhësor.

Në këtë punim synojmë të shohim situatën e përfuturit dhe përdorimit të gjuhës së dytë, sipas një këndvështrimi të ri duke u mbështetur në literaturën bashkëkohore me një metodologji pune dhe analize që këto teori të reja ofrojnë. Do të analizojmë:

- Si ndryshon statusi i gjuhës me kalimin e viteve?
- Si rriten apo veniten gjuhët e bilingualit si dhe faktorët që ndikojnë.
- Si bilinguali përzgjedh gjuhë të ndryshme për t'i përdorur në fusha të ndryshme?
- Si sillen folësit bilingual në situata apo dialogë të ndryshëm?
- Si bilingualët ç'aktivizojnë gjuhët e tjera kur janë në një model monolingual duke u vendosur kështu në skajin monolingual të vargut dhe se si do të rrëshqasin tek gjuhët e tjera në skajin bilingual të vargut.

Në këtë punim do të shohim edhe ndikimin që ka shqipja me specifikat e saj si gjuhë , në raste kur ajo është L1 për folësit.

Do të prezantojmë rezultatet e kërkimeve të bëra me individë që përdorin dy ose më shumë gjuhë. Ky kërkim ka një shtirje të gjatë kohore, psi kemi vëzhguar këto bilinguale ndër vite.

Fjalë kyçe: dygjuhësi, njëgjuhësh, gjuha shqipe, perceptim, strukturë gjuhësore.

1. BILINGUIZMI

Procesi i të folurit dhe i të kuptuarit të gjuhës bën pjesë në eksperiencat tona të përditshme. Në kushte normale këto procese i realizojmë pa sforcim dhe me një shpejtësi të habitshme.

Për të kaluar një mendim në fjalë dhe fraza gjatë komunikimit nuk është i nevojshëm asnjë sforcim, përkundrazi mjafton një refleksion minimal. Gjithashtu në mënyrë të ngjashme nuk kemi asnjë problem për të kuptuar mendimet e shprehura në fjalë dhe shprehje nga të tjerët. Mund të duket shumë i çuditshëm fakti që këto procese dhe kjo mundësi e jona për të komunikuar, edhe pse i realizojmë pa sforcim, në thelb janë shumë kompleksë. Nëse këtë pohim e bëjmë për individët që janë monolingualë, çfarë duhet të mendojmë për bilingualët?

Çfarë situatash psikolinguistike dhe neurolinguistike duhet të përballojnë bilingualet kur kalojnë nga përdorimi i njerës gjuhë tek gjuha tjetër?

Si ndikon gjuha shqipe me karakteristikat e saj leksikore, gramatikore dhe fonetike tek individët bilingualë që kanë L1 gjuhën shqipe?

Vitet e fundit po flitet shumë për bilinguizmin si një proces gjuhësor me të cilin po ballafaqohen përdoruesit e gjuhës, po analizohen problematikat gjuhësore me të cilat përballen folësit bilingualë. Ky interesim i studiuesve lidhet direkt me realitetin e sotëm, ku lëvizjet nga njëri vend në tjetrin janë shtuar shumë. Koncepti i kufijve si pengesë për lëvizjen e lirë të njerëzve ka ndryshuar. Kemi lëvizje të njerëzve nga njëri vend në tjetrin për pafundësi arsyesh. Jashtë këtij realiteti nuk mbesin dhe shqiptarët, përkundrazi në 30 vitet e fundit lëvizja e tyre jashtë kufijve është rritur shumë.

Arsyet pse janë shtuar bilingualet të cilët kanë L1 gjuhën shqipe:

- Emigrimi.
- Shumë studentë ndjekin studimet e tyre jashtë Shqipërisë në një gjuhë të ndryshme nga shqipja.
- Martesat me shtetas të huaj.
- Mundësitë profesionale jashtë Shqipërisë.

Në këtë punim do të analizojmë dy faktorë të rëndësishëm të bilinguizmit:

- rrjedhshmëria e gjuhës
- ndryshimi potencial i nivelit të ekzekutimit të njërës prej gjuhëve apo disa gjuhëve.

Në këtë punim do të analizojmë situatën e bilinguizmit për individë që L1 (gjuhë të parë) kanë gjuhën shqipe, ndërsa L2, L3, L4, L5 (gjuhë të dytë, të tretë ,etj) sipas rastit kanë anglishten, italishten, gjermanishten dhe frëngjishten apo turqishten).

2. RRJEDHSHMËRIA E GJUHËS

Bilinguizmi është përdorimi i dy ose më shumë gjuhëve (ose dialekteve) në jetën e përditshme (Grosjean & Li, 2013). Një individ bilingual nuk ka rrjedhshmëri të njëjtë në përdorimin e gjuhëve që njeh.

Kemi marrë në studim disa individë me L1 gjuhën shqipe të përfshirë në situatë bilinguizmi. Këto individë janë mbajtur në vëzhgim për disa vite dhe kemi ruajtur të dhëna në lidhje me përdorimin e gjuhëve që njohin.

Elementi i parë që na bie në sy në këtë analizë është fakti që njëra gjuhë fiton përdorim ndaj gjuhës tjetër për qëllime të ndryshme:

- vendbanimit
- punësimit
- shkollimit
- fushës së interesit

Nëse analizojmë individë bilingualë do të shohim se në njërën gjuhë mund të kenë aftësi shumë të mira në të folur, në theks dhe shqiptim, por në të shkruar mund të kenë probleme.

Me kalimin e viteve, në varësi të eksperiencave gjuhësore të individit gjuhët mund të ndryshojnë vendet sa i takon përdorimit dhe rrjedhshmërisë.

Kur flasim për rrjedhshmërinë e një gjuhë, si faktor përcaktues studiuesit kanë rënë dakort të vendosin theksin në përdorimin e gjuhës. (Weinreich (1968) dhe Mackey (2000))

Për vite të tëra kemi bërë vëzhgime të shumta të emigrantëve shqiptar që jetojnë në vende të ndryshme të botës kryesisht në vendet anglishtfolëse, konkretisht Amerikë, Kanada dhe Angli, por edhe në Francë, Itali dhe Gjermani,

Pjesë e studimit janë bërë edhe studentët që kanë bërë studimet jashtë Shqipërisë si dhe personat që janë martuar në vende të ndryshme.

Për efekt analizimi dhe konkretizimi, kemi shkëputur njërin nga individët bilingualë të marrë në studim.

Më poshtë do të paraqesim bilinguizmin e një personi në dy momente të jetës: në moshën 23 dhe 32 vjeçare. Ai quhet Endrin dhe në moshën 23 vjeçare u largua për në Gjermani për studime. Kur u largua nga Shqipëria, ai njihje gjuhën shqipe dhe angleze dhe pak gjuhën gjermane. Në tabelë boshti vertikal perfaqëson përdorimin e gjuhës, ndërsa boshti horizontal perfaqëson rrjedhshmërinë e gjuhës (Grosjean & Li, 2013).

Tabela 1. Statusi në moshën 23 vjeçare (kur jetonte në Shqipëri)
L1= shqip L2=anglisht L3 = gjermanisht

çdo ditë				L1
			L2	
kurrë				
		L3		
	i ulët			i lartë

Në tabelën 1 shohim situatën gjuhësore të individit në moshën 23 vjeçare, i cili në atë periudhë ishte në mbarim të studimeve në Mjekësi në Universitetin e Tiranës.

Grafiku vertikalisht tregon përdorimin e gjuhës: nëse përdoret çdo ditë, apo njëra nga gjuhët nuk përdoret kurrë. Ndërkohë që horizontalisht shohin sesa fluent është individit në gjuhën përkatëse.

Individi i marrë në studim ka si L1 gjuhën shqipe, L2 gjuhën angleze dhe L3 gjuhën gjermane.

Shohim se në këtë periudhë individit ka një përdorim shumë të mirë të L1 dhe çdo ditë përdor këtë gjuhë. Ndërsa gjuha angleze dhe gjermanishtja kanë përdorim më të ulët. Anglishtja përdoret mesatarisht, pasi disa lëndë dhe literatura shkencore në procesin mësimor janë bërë anglisht. Gjermanishten e shohim në rreshtin e fundit, pasi studentit sapo ka nisur ta mësojë dhe ende nuk ka nisur të komunikojë gjerësisht me të.

Tabela 2 Statusi në moshën 32 vjeçare (pas rreth 8 vitesh emigrim)
L1 = shqip L2 = anglisht L3 = gjermanisht

çdo ditë			L3	
				L1
kurrë		L2		
	ulët			i lartë

Në tabelë 2 kemi bërë në formë grafike të dhënat e marrë nga momenti i dytë i analizës që i është bërë Endri.M. në moshën 32 vjeçare. Personi në fjalë mbaroi studimet në Mjekësi në Universitetin e Tiranës në vitin 2014, aplikoi dhe fitoi Masterin në Gjermani.

Tashmë ai vihet para një situatë të re. Gjermanishtja që për të ishte L3, tani duhet të mësohet, pasi studimet në Master ishin në gjermanisht. Personi në fjalë pas përfundimit të studimeve nuk u largua, por vazhdoi të punonte në Gjermani. Tashmë L3, gjermanishtja për të është kthyer në gjuhën e përdorimit të përditshëm.

Edhe pse kishte shumë vite në Gjermani individit nuk kishte arritur pikën më të lartë të përdorimit fluent të gjermanishtes. Shqipja vazhdonte të ishte gjuha më fluente edhe pse përdorej më pak se gjermanishtja.

Ndërkohë anglishtja nga gjuha e dytë e huaj e përdorur menjëherë pas gjuhës shqipe, kur individi ishte në Shqipëri, ka ndryshuar pozicion. Pas rreth 7 viteve në Gjermani, anglishtja ishte më pak e përdorur nga tre gjuhët që njihje individi. Pas shumë vitesh në Gjermani, gjermanishtja kalon në krye të tabelës.

3. NDRYSHIMI POTENCIAL I NIVELIT TË EKZEKUTIMIT TË NJËRËS PREJ GJUHËVE

Nga analiza që bëme identifikuaam faktin se me kalimin e viteve kemi ndryshim potencial të nivelit të ekzekutimit të njërës apo tjetrës gjuhë.

Mund të themi se individi Endri. M në moshën 23 vjeçare ka L1 gjuhën shqipen pasi është më e përdorura. Vendi i shqipes në një farë mënyrë zihet nga gjermanishtja pas 7 vitesh qëndrimi atje.

Në tabelën e parë shohin se Endri. M është kryesisht bilingual mes gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze; gjermanishtja është gjuhë që e njih shumë pak dhe që nuk e përdorte kurrë. Ndërsa pas 7 vitesh situata ndryshon: Endri. M është kryesisht bilingualë mes shqipes dhe gjermanishtes.

Shembulli që paraqitem në këtë punim është përzgjedhur mes një numri të madh individësh të marrë në studim. U ndalëm këtu pasi na u duk ndër më interesantët. Megjithatë vlen të trajtohen edhe çështjet e bilingualizmit të emigrantëve të cilët janë larguar nga Shqipëria për arsye punësimi. Në thelb kemi të bëjmë me të njëjtën situatë si tek rasti që analizuaam më në detaje.

Që të kemi një përfundim edhe më të saktë mbi përdorimin e gjuhëve dhe nivelit të rrjedhshmërisë, analiza është ndaluar në të gjithë komponentët përbërës të gjuhës : në të folur, në të shkruar, në të dëgjuar dhe në të lexuar.

Tek emigrantët kryesisht gjejmë rëndom raste kur i njëjti individ ka nivele të ndryshme njohjeje të komponentëve përbërës të njohjes së gjuhës. Ata janë kryesisht përdorues shumë të mirë të L2 në të folur dhe në të dëgjuar, më pak në lexim dhe akoma më pak në të shkruar.

Tek bilingualët studentë kemi njohje shumë të mirë të gjuhëve L1 dhe L2 në të katër përbërësit: në të folur, në të dëgjuar, në lexim dhe në të shkruar.

Është e rëndësishme njohja e historikut të gjuhëve që njohin dhe përdorin bilingualët: cilat gjuhë janë fituar, kur dhe si; cili është grafiku i rrjedhshmërisë dhe përdorimit në vite; nëse disa gjuhë kalojnë periudha ristrukturimi në ndikimin e një gjuhe tjetër më të fortë, ose mund edhe të kthehen në gjuhë të fjetura dhe ngadalë harrohen në vitet më vonë.

Pjesë e studimit tonë ishin edhe rastet kur përdorues dhe njohës të disa gjuhëve, pas largimit nga Shqipëri përballen me gjuhë të reja që nuk i kanë njohur më parë.

Mes shembujve të marrë në studim, po ndalemi tek çifti i bashkëshorteve Jonida.D dhe Edmond.D. Deri para 15 viteve ata kanë jetuar në Shqipëri. Janë zhvendosur në Francë për studime, ku kanë jetuar rreth 10 vite. Më pas kanë lëvizur drejt Amerikës, ku jetojnë prej 5 vitesh.

Në momentin kur kanë shkuar në Amerikë kanë njohur shume mirë gjuhën shqipe, frengjishten dhe jo shumë mirë anglishten. Me vendosjen e tyre në Amerikë dhe për shkak të punës u është dashur të mësonin italishten dhe gjermanishten. Punojnë në të njëjtën kompani me degë në vende të ndryshme të botës.

Tashmë Jonida dhe Edmondi kanë ndryshuar konfigurimin e gjuhëve që njohin, duke ndryshuar nivelet e përdorimit të tyre. Madje kanë mësuar dhe gjuhë të huaja të tjera. Pas 15 vitesh larg Shqipërisë ata janë njohës të 5 gjuhëve:




Tabela 3. tregon sesi ndryshon konfigurimi i përdorimit dhe njohjes së gjuhëve të huaja, në varësi të eksperiencave jetësore. Madje shohim se edhe individë të ndryshëm mund të paraqesin të njëjta situata, nëse janë përballë të njëjtave kushte, siç ishte rasti i çiftit që morëm në studim.

Nga tabela shohim se gjuha L1 është zhvendosur më poshtë dhe më majtas që do të thotë që gjuha L1 (shqipja) përdoret tani më rrallë dhe si rezultat bilinguali është më pak i rrjedhshëm në këtë gjuhë. L2 (frëngjishtja) është zhvendosur gjithashtu më poshtë dhe më majtas, pasi tani nuk përdoret çdo ditë.

L3 (anglishtja) ka ndryshuar situatë, është ngjitur lart dhe është zhvendosur djathtas, pasi tani përdoret çdo ditë. Për më tepër, dy gjuhë të tjera janë fituar: L4 (italishtja), e cila tani për arsye të punës përdoret pak, po ashtu edhe L5 (gjermanishtja).

4. INDIVIDU BILINGUAL PËRBALLË PROBLEMEVE NË KOMUNIKIM

Të harruarit e gjuhës është një fenomen që mund të ndodhë gjatë jetës së individit, është një fenomen i shpeshtë, po aq i shpeshtë sa vetë të mësuarit e gjuhës, por që ka marrë shumë më pak vëmendje. Gjatë procesit të humbjes së njërës prej gjuhëve, zotërimi dhe përdorimi i saj pakësohet dukshëm, ose ndonjëherë zhduket krejtësisht. Shenjat e humbjes shfaqen me kalimin e kohës: të prodhuarit e gjuhës është i mbushur me probleme në gjetjen e fjalëve dhe hezitime; theksi i personit ndikohet nga theksi i gjuhës tjetër më të fortë, ashtu si dhe sintaksa; folësi u kthehet gjuhëve të tjera gjithnjë e më tepër për një fjalë apo shprehje, e kështu me radhë. Për më tepër, bilingualët bëhen shumë të pasigurtë në vetvete, kur ata duhet të përdorin gjuhën dhe shpesh deklarojnë që ata nuk e dinë më gjuhën. Edhe të kuptuarit ka probleme, por më pak se të folurit.

Një folës monolingualë me një shpejtësi normale të folurit prodhon rreth 150 fjalë në minutë, mesatarisht një fjalë për 400 milisekonda. Nën trysinë e kohës, shpejtësia mund të dyfishohet me lehtësi në një fjalë për 200 milisekonda (Field, 2006).

Një folës i rritur monolingualë, ka një fjalor aktiv prej rreth 30 mijë fjalësh dhe bën zgjedhjen e duhur nga këto 30 mijë alternativa jo vetëm një herë, por, kur flet rrjedhshëm, vazhdimisht dy deri në pesë herë në sekond, një shpejtësi që mund të mbahet pa ndonjë kufizim të dukshëm kohor. Individu bilingualë ka fjalor aktiv të dy ose më shumë gjuhëve, ndaj dhe përzgjedhja që bën ai për të zgjedhur lemën e duhur vështirësohet. Situata ndërlikohet më shumë kur lemat e kërkuara nga folësi bilingualë i përkasin fjalorit “të fjetur”. Problematikat shtohen kur bashkangjiten edhe vështirësitë në aspektet gramatikore.

Për të ilustruar këtë, gjatë pushimeve kryesisht verore kemi pasur mundësinë të takojmë dhe vëzhgojmë një numër të konsiderueshëm emigrantësh shqiptarë (32 vetë) të cilët jetojnë në vende të ndryshme të botës. Subjektet të cilët janë larguar shumë vite më parë kanë më shumë probleme me gjuhën. Ata të cilët janë larguar që në fëmijëri dhe kanë kaluar shumë vite në një vend tjetër kanë humbur rrjedhshmërinë në gjuhën shqipe.

Një ndër problemet që ndeshet është vonesa në gjetjen e fjalës së kërkuar. Mbi 30 personat e përfshirë në këtë analizë shfaqin probleme me vonesa për të gjetur fjalën e duhur, Gjatë prodhimit gjuhësor, rrjedha e të folurit humb vijën logjike, pasi folësi bilingual duhet të bëjë kërkim në zonën e ruajtjes së lemave. Lind pyetja : cilat fjalë ka vështirësi folësi bilingual të gjejë, ndërkohë që ndërron kodin e komunikimit nga njëra gjuhë në tjetrën ?

Nga vëzhgimet e bëra kemi arritur në përfundimin se bilingualët nuk paraqesin të njëjtën vështirësi në prodhimin e fjalëve. Shprehjet që janë në formë « formulash » që ruhen si një e tërë bilinguali i prodhon shpejt, ndërsa vonesën e ka në lemat kumtimplota, kryesisht emra dhe folje.

-Sa kushton ky..... (kamioni) ?

-Kam shumë frikë nga (errësira).

Theksi i personit ndikohet gjithnjë e më tepër nga gjuha tjetër dominuese :

-Të lutem njofto doktorin. (me theks tek /o/ e parë).

-Të lutem një hamburger. (me theks tek /e/)

Sintaksa e subjektit ndikohet nga ajo e gjuhës tjetër.

-Unë u linda në Shkoder. (Nga anglishtja : I was born in Shkoder.)

-A do më martosh mua ? (Ëill you marry me ?)

Rendi i fjalëve:

-Sa i bukur ky merceds benxi! (Nga anglishtja, ku mbiemri vendoset para emrit.)

Folësi u kthehet fjalëve apo shprehjeve të gjuhës të cilën ai përdor në vendin tjetër:

-Babai im punon si dormen në një hotel.

-Po shkoj për drekë tek gren. (gran. Shkurtim i fjalës grandfather apo grandmother.)

Subjekti nuk bën përshtatje në numër mes emrit dhe foljes, duke bërë një kalk të përdorimit nga anglishtja.

-Flokët e mi është i zi. (Sepse në gjuhën angleze emri “hair” ndiqet nga një folje në numrin njëjës.

5. PËRFUNDIM

Në përfundim të këtij punimi mund të themi se individët bilingualë përballen me vështirësi të ndryshme gjatë procesit të komunikimit në varësi të gjuhës që përzgjedhin të përdorin. Kalimi nga përdorimi i një gjuhë në një gjuhë tjetër nuk është thjeshtë dëshirë e bilingualit, por domosdoshmëri e përcaktuar nga kushte të caktuara, të cilat bëjnë që gjuhët e bilingualit të zhvillohen apo të zbehen me kalimin e viteve.

Mosha në të cilën fitohet një gjuhë, si fitohet dhe sasia e përdorimit që i jepet në vite, luajnë një rol në cilësinë e njohjes së gjuhës, si procesohet ajo, biles edhe në mënyrën se si truri ruan dhe vepron me të.

BIBLIOGRAFI

Chumbow, S. (2018). *Multilingualism and Bilingualism*

Field, J. (2006). *Psycholinguistics*, Routledge, London.

Grosjean, F., & Li, P. (2013). *The Psycholinguistics of bilingualism*, Blackwell Publishing, Ltd, USA.

Mackey, W. (2000). The description of bilingualism. In Li Wei (ed.), London: Routledge, 2017.

Menn, L. & Dronkers, F. (2017). *Psycholinguistics: Introduction and Applications*, Second Edition, USA.

Miller, B. & Rothman, J. & Serratrice, L. (2018). *Bilingual Cognition and Language: The state of the science across its subfields*.

Rueschemeyer, S.-A., & Gaskell, M. G. (2018). *The Oxford Handbook of Psycholinguistics*, Oxford Library of Psychology.

Traxler, M., & Gernsbacher, A.M. (2011). *Handbook of Psycholinguistics*, second edition, Oxford.

Weinreich, U. (1968). *Languages in Contact*. The Hague: Mouton.